



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 92, datë 10.04.2020

**PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR PROKUROR NË
PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 6 dhe 7 të Ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në nenin 159 të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe mbështetur në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” miratuar me vendim nr. 51, datë 19.03.2019 nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I :

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) përmes procedurës së ngritjes në detyrë.
2. Të caktojë Komisionin e Posaçem për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e prokurorëve në SPAK.
3. Njoftimi dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të publikohen në faqen zyrtare të Këshillit.
4. Shprehja e interesit duhet të dorëzohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga publikimi i shpalljes në faqen zyrtare të institucionit dhe të dorëzohet në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Qemal Stafa” nr.1, godina e Prokurorisë së Përgjithshme.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

